**Përmbledhje e komenteve/rekomandimeve nga sesioni informues i Keshillit te Bashkise Lushnje me qytetaret dhe grupet e interesit**

***Keshilli i Bashkise falenderon qytetaret per pjesemarrjen ne kete takim dhe per rekomandimet e dhena per permiresimin e punes per infortmimin dhe komunikimin me te mire te keshilltareve ne cdo zone me qytetaret e tyre.***

| |
|---|
| Titulli i Takimit: Sesion informues i Keshillit te Bashkise per qytetaret.<br>Qellimi: Qytetaret te njohin rezultatet e KB per permiresimin e komunikimit me qytetaret dhe te marrin rekomandime per nje qeversje sa me te mire. |
| 26 Shtator 2025, ora 11:00 ne Sallen e Keshillit te Bashkise |
| Morren pjese 53 persona, 23 femra |
| **Përmbledhje e sesionit:**<br>Takimi u drejtua nga kryetari i Keshillit z. Erjet Dhima, N/kryetrja znj. Kozeta Guci dhe kryetari i komisionit per arsimin z. Pirro Kallajxhiu dhe pjesemarresit moren materiale informuese per Keshillin (flete palosje).<br><br>Z.Erjet Dhima, mbas falenderimit per asistencen e projektit te BtF, dha nje informacion te shkurter per qytetaret per rolin e Keshillit te Bashkise si perfaqesues, vendimarres dhe monitorues dhe evidentoi me te dhena konkrete punen e deritanishme te tij ne vendimarrjet kryesore per qytetaret dhe ne konsultim me ta. Prezantimi u perqendrua tek permiresimi i mjeteve te informimit te KB me qytetaret, duke nenvizuar sesionet e hapura te Keshillit, transmetimin live te mbledhjeve, sesionet e hapura te komisioneve etj ( ne faqen zyrtare te Bashkise dhe face book) dhe kontaktet e cdo keshilltari dhe komisioneve per te adresuar ceshtjet per zgjidhje.<br><br>Qytetaret vleresuan takimin dhe evidentuan ndryshime te komunikimit te Keshillit me ta si dhe evidentuan dhe pune te mira publike ne bashki ne maredhenie edhe me qytetaret.<br>Disa prej tyre evidentuan dhe problematika te perdishme per rruget, qetesine publike, ceshtje sociale, vleresimit te figurave ne qytet etj. (por keto mbeten per diskutim ne takimet e tjera per buxhetin)<br><br>Pjesemarresit, referuar temes te takimit, bene mjaft propozime dhe per permiresimin e punes se komunikimit dhe informimit nga Keshilli i Bashkise per qytetaret.<br><br>**Ceshtjet e ngritura**<br><br>- Nuk njihen akoma keshilltaret e zones per tu adresuar problemet qe ata kane, kjo ben qe u adresohen vetem njesive administrative, ku shpesh nuk marrin pergjigje.<br>- Nuk kane marre pjese ne asnje mbledhje te Keshillit te Bashkise, nuk ka vende per qytetaret dhe nuk ka njoftime dhe ne leter ne njesite administrative per keto mbledhje<br>- Nuk kane marre asnjehere njoftime individuale per ndonje mbledhje te vecante te KB apo te komisioneve per ceshtje qe kerkojne ekspertize nga qytetare/intelektuale te fushes apo eksperte te jashtem<br>- Keshilli ka marre vendime, por nuk njohim asnje rast qe Keshilli i Bashkise te kete verifikuar si zbatohen vendimet e saj, njohim raste qe nuk behen punet sipas vendimeve qe ka |

marre keshilli.
- Nuk kemi mundesi te perdorin tekonologjine per marrjen e informacionit per mbledhjet e keshillit dhe komisioneve, te perdoren dhe forma te tjera komunikimi.
- Kemi bere ankesa dhe kerkesa prane bashkise po nuk kemi marre pergjigje
- Media lokale nuk angazhohet per ceshtje te vecanta te ndjeshme per qytetaret as nga Bashkia dhe as nga KB. Nuk vleresohet media per ndikimin qe ka per informim qytetar.

**Rekomandime**

- Te behet nje rikonstruksion i salles se KB-se se edhe kur ndjekim live mbledhjet nuk ka degjim te mire per shkak hapesires se ngushte per ti maree nga afer keshilltaret.
- Qe te ndjekim te pakten mbledhjet e komisioneve, njoftimet te mos behen vetem ne faqen web te KB, face book, por edhe ne qendrat administrative te ngjiten njoftimet.
- Disa mbledhje komisionesh per PVendime te canta qe lidhen me nje zone apo grup interesi te vecante te organizohen jo vetem ne sallat e KB, por te xhvendosen dhe tek ne direkt ne baze, qe ti ndjekim dhe te japim mendimet tona.
- Me shume zhurme te behet per te ndjekur konsultimet publike, sepse nuk marrim vesh dhe nuk behemi pjese e tyre. Duhet te dime qe tani kalendarin qe ka Keshilli per takimet publike per buxhetin.
- Te monitorohet zbatimi i disa vendime te ndjeshme per qytetaret nga KB, duke organizuar median dhe pjesemarrjen e qytetareve ne monitorim
- KB te kete marreveshje pune me mediat lokale per te bere publicitet dhe ngritur ceshtje nga qytetaret per keshilltaret. Edhe ne takimet publike, mire do ishte te kerkonin median prezent per te sensibilizuar qytetaret dhe zgjidhur problemet nga Bashkia

Data e publikimit të përmbledhjes së komenteve/rekomandimeve: 29 shtator 2025